

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtaret Suzana Çerkini, kryetare e trupit gjykues, Shpresa Hasaj - Hyseni dhe Arben Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të akuzuarve L.B.nga P., E.M.nga P. dhe N.Z.nga P., për shkak të veprës penale Grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK, ndersa i akuzuari L.B.edhe per shkak te vepres penale, mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK, te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.35/2017 datë 28.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me data 16.10.2017, 04.12.2017, 26.01.2018, 21.02.2018 dhe 06.03.2018 me praninë e prokurorit të shtetit Besa Limani, të akuzuarit L.B., me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyres zyrtare av.N.Xh. dhe te akuzuarit E.M.,me mbrojtësen se tij të caktuar sipas detyres zyrtare av. F.K., me date 09.03.2018 merr dhe shpall këtë:

## A K T G J Y K I M

### **Te akuzuarit:**

**L.B.**, nga babai V. dhe nëna F., e vajzërisë B., i lindur më datë ..., në P., ku edhe jeton ne rr.“S.”, pn, ka të kryer shkollen e mesme, i pamartuar, i papunësuar, i gjendjes së dobet ekonomike, nuk ka qenë më parë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës,

**E.M.**, nga babai F. dhe nëna S., e vajzërisë F., i lindur më datë ..., në fshatin B., komuna e P., kurse jeton ne “L. e K.”, ka të kryer shkollen fillore, i pamartuar, i papunësuar, i gjendjes së dobet ekonomike, nuk ka qenë më parë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, me nr. personal ..., Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës,

**Në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPP,**

**-I-**

## **LIROHEN NGA AKUZA**

**Sepse,** me datë 09.03.2017, duke vepruar si anetare te grupit te cilet kane me vete arme dhe mjetet e rrezikshme, me qellim per te pervetsuar pasurine e luajtshme te personit tjetet, qe ti sjellin vetes apo personit tjetet dobi pasurore te kunderligjshme, pas marrveshjes paraprake ne mes te pandehurve L.B., E.M., N.Z.me te miturin N.M. per te kryer vepren penale te grabitjes, i pandehuri L.B.ka marr me qira per 25 euro ne dite veturen e tipit “Golf 4” me targa ... ne fshatin G., Komuna

P., tek firma "R. C. te B.", prone e deshmitarit B.H., pastaj i pandehuri L. ka shkuar ne shtepine e tij ne P., ku ka marre revolen, thiken, dy maska te zeza dhe tri pale doreza dhe me kete veture te pandehurit dhe i mituri, me qellim qe te kryejne vpren penale te grabitjes, kane shkuar ne Prishtine dhe jane ndalur prane marketit "D.-R" ne Dardani., ku ka qene duke punuar e demtuara, deshmitarja F.M., e cila eshte pronare e ketij marketi dhe, te pandehurit kane zbritur nga vetura, kane pritur momentin e pershtatshëm per te hyre dhe per te grabitur ne kete market kur e demtuara te mbetet vetem, mirepo vepra penale ka mbet ne tentative sepse aty ka patur shume njerez dhe marketi në nderkohe eshte mbyllur, te pandehurit nuk kane mundur ta kryejne grabitjen, e pastaj te pandehurit me te njejten veture dhe te njejtin qellim jane nisur ne Fushe Kosove, mirpo gjate rruges ishin ndalur nga patrulla policore ku gjate kontrollimit nga ana e policise, ne veture kane gjetur dhe sekuestruar nje revole, nje revole loder, nje thike, dy maska dhe tri pale doreza.

-me këtë kishin per te kryer veprën penale Grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK,

- pasi që nuk është provuar se te njëjtit kane kryer veprën penale për të cilën akuzohen,
- Shpenzimet e procedures penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate,
- Kërkesë pasurore kuridiek nuk pati,

**Në bazë të nenit 365 të KPP, i akuzuari L.B.:**

**-II-**

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse nga muaji mars i vitit 2016, ne shtepine e tij ne rrugen "S." ne P., ka mbajte ne pronesi arme, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armet e tilla, ndersa me daten 09.03.2017 ne rrugen "Dardania" ne Fushe Kosove, gjate kontrollimit nga ana e policise, të njëjtit ia kanë gjetur dhe sekuestruar armen e zjarrit te llojit "Ekol Special", me nr.serike SB 15, te kal.7.65mm,

- me kete ka kryer vepren penale Mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK,

Andaj gjykata konform neneve7, 17, 21, 41,42, 43, 45 62 par.2.6, 69, 73, 74të KPRK dheneneve365, 366të KPP, ishqipton,

**DENIM ME BURGIM**

Ashtu që i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtate) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 09.03.2017 deri me datën 16.10.2017, ashtu që 1 (nje) dite e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (nje) dite e dënimit me burgim,

Konfiskohet arma e zjarrit e llojit "Ekol Special", me nr.serike SB 15, të kalibrit të vogël 7.65mm,

Detyrohet i pandehuri që ta paguaje paushallin gjyqësor në shumë prej **50 euro**, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) diteve, nga dita kur aktgjykimi të bëhet në formë të prerë,

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë Departementi i Krimeve të Renda, ka parashtruar aktakuzë PP.I.nr.35/2017 të datës 28.04.2017 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departementit të Krimeve të Renda, kundër L.B., E.M.dhe N., për shkak të veprës penale Grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK, ndërsa ndaj të akuzuarit L.B.edhe për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 12.05.2017, në të cilin të tre të akuzuarit në prani të mbrojtësve të tyre, pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtin, kanë mohuar fajsinë për veprën penale Grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK, ndërsa i akuzuari L.B.ka pranuar fajsinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, të cilin pranim e mbështeti edhe mbrojtësi i tij, meqë ishin konsultuar me të njëjtin dhe ky pranim ishte shprehje e vullnetit të mbrojturit të tij. Gjithashtu edhe prokurori i shtetit u pajtua me pajtimin e fajsisë sa i përket të akuzuarit L.B.lidhur me veprën penale nga pika II e aktakuzës, meqë konsideron se pranimi është bërë komform dispozitave ligjore të KPP, e më pas edhe gjykata aprovoi pranimin e fajsisë nga i akuzuari L.B., i cili pranim ishte bërë me vullnet të plotë nga i akuzuari, i njëjti ka qenë në dijeni të plotë për përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajsisë dhe për këtë paraprakisht ishte konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe pranimi ishte në pajtim me provat nga shkresat e lëndës, i mbështetur në faktet e ceshtjes dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike.

Megjithatë të akuzuarit nuk pranuan fajsinë për veprën penale si në pikën një të këtij aktgjykimi, të njëjtit shfrytëzuan të drejtën për të parashtruar kërkesë për hüdhe të aktakuzës dhe pasi që gjykata

mori vendim refuzes i cili vendim edhe mori formën e prerë, vazhdoi me procedurën e shqyrtimit kryesor në këtë çështje penale.

2. Fjala përfundimtare e paleve per vepren penale Grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK,

Gjate vazhdimit te shqyrtimit gjyqesor, meqenëse i akuzuari N.Z.kishte ikur nga vendi dhe sipas konfirmimit zyrtar të policisë i njëjti gjendej në shtetin e F., andaj meqenëse ishte i paarritshëm për gjykatën, gjykata ka veçuar procedurën penale ndaj te akuzuarit N.Z., për të vazhduar me dy të akuzuarit tjerë të pranishëm.

Meqë te akuzuarit L.B.dhe E.M.nuk e kanë pranuar fajsinë për kryerjen e veprës penale grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK për të cilën janë akuzuar, atëherë gjykataka administruar provat e paraqitura në shqyrtim kryesor dhe në fund, palët kanë paraqitur fjalëte tyre përfundimtare. Ne fjalën përfundimtare dorezuar me shkrim kesaj gjykate, prokurori i shtetit Besa Limani ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, respektivisht dispozitivit te parë të aktakuzes, duke aluduar ne ate se nga deklarata e te demtuares, deshmitarit, pjeserisht nga deklarata e të akuzuarve dhe nga provat materiale, pa medyshje eshte vertetuar se te akuzuarit kanë kryer vepren penale si dispozitivin nën pikën I te aktakuzes, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarit L.B.dhe E.M.t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit duke i marre per baza rrethanat renduese, si rrezikshmerine e vepres penale dhe shkallen e larte te dashjes, kurse si rrethane lehtesuese te merr faktin se i akuzauri Labinot e ka pranuar fajshine per vepren penale nen piken II te pershkrimmit faktik te aktakuzes.

Mbrojttesi i te akuzuarit L.B.av.N.Xh., ne fjalën e tij përfundimtare dorëzuar gjykates në formë të shkruar, ka deklaruar se e kundërshton aktakuzën e prokurorisë se shtetit, te parashtruar ndaj te akuzuarit per vepren penale grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK, pasi që qe me asnje fakt dhe prove apo deshmi relevante nuk eshte provuar se i mbrojturi i tij ka kryer vepren penale, andaj mbi bazen e saj i ka propozuar gjykates te akuzuarin t'a lirojë nga aktakuza.

I akuzuari L.B.në fjalën e tij përfundimtare e ka mbeshtetur ne teresi fjalën përfundimtare të mbrojtetit te tij.

Mbrojtjesja e te akuzuarit E.M.av.F.K., ne fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton aktakuzën e prokurorisë se shtetit sa i përket të mbrojturit të saj të akuzuar për veprën penale grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK, pasi qe nuk jane permbushur elementet kryesore të kësaj vepre penale siç janë dhuna apo kanosja, ndërsa nga faktet dhe provat mbi te cilen mbeshtet aktakuza nuk eshte vertetuar dhe nuk eshte provuar se i mbrojturi i saj ka kryer këtë vepër penale, andaj mbi bazen e kësaj i ka propozuar gjykates te akuzuarin E.M.t'a lirojë nga aktakuza.

I akuzuari E.M.në fjalën e tij përfundimtare e ka mbeshtetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

### 3. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike të lartcekur, trupi gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave:

- dëgjimin e të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares F.M.;
- dëgjimin e dëshmitarit B.H.;
- dëgjimin e dëshmitarit N.M.;
- leximin dhe shikimin e provave materiale, siç janë: Lista e armëve të konfiskuara; Dy vertetime mbi marrjen e perkohshme të gjesendeve të datës 10.03.2017; kontrata për dhënie me qira e datës 09.03.2017, deftesa mbi kthimin e pronës e datës 15.03.2017, dhe foto dokumentacioni në shkresë të lëndës si dhe
- marrjen në pyetje të akuzuarit L.B. dhe
- marrjen në pyetje të akuzuarit E.M..

#### 3.1. Deklarata e të dëmtuarës F.M., në cilësi të dëshmitares

E dëmtuara F.M., gjatë dhënies së dëshmisë së saj në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se lidhur me këtë çështje ka dhënë një deklaratë pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë. E njëjta ka treguar se me datë 10.03.2017 në lokalitetin e saj në D., kishte shkuar policia dhe e kishte informuar se dikush ka pasur plan të bëjë grabitje në lokalitetin e saj, mirëpo fatmirësisht ajo kishte pasur myshterinjë dhe grabitësit nuk kishte arritur të hyjnë në lokalitet. Pastaj vazhdon duke shpjeguar se një natë më parë kishte punuar në lokalitetin deri rreth orës 23:00 kur edhe e kishte mbyllur dhe i kishte lëshuar grilat e lokalitetit, më tej afër 200 metra më larg se lokaliteti i kishte vërejtur tre djem me duksa me kapulaqë në kokë, të cilët pishin cigare dhe e njëjta ka vazhduar drejtimin e vet, por nuk e ka vërejtur se ata djem po e shikojnë të njëjtën se nga po shkon. Dhe tani në seancë kur i ka shikuar të akuzuarit, theksoi se nuk i ka parë të njëjtit ndonjëherë më parë. Të nesërmen kur ka ardhur në punë për ta hapur lokalitetin nuk ka vërejtur ndonjë gjë të pazakontë në hyrje të lokalitetit, ngase sipas saj lokaliteti ka pasur edhe alarm, dhe nuk i është bërë kurrfarë dëmi që do të kishte mundur me e vërejtë. Andaj, sipas saj nuk ndihet e dëmtuar për asgjë nga të akuzuarit dhe nuk dëshiron të parashtojë kërkesë pasurore juridike, në fund ka deklaruar se para dy viteve pra në vitin 2015, i është thyer lokaliteti nga dikush, dhe nga ajo kohë me nuk ka pasur asnjë dëmtim tjetër.

#### 3.2. Deklarata e dëshmitarit B.H.

Dëshmitari B.H., gjatë dhënies së dëshmisë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në atë kohë ka qenë në Lipjan kur kishte thirrë në telefon bashkëshortja e tij dhe i kishte treguar se një veturë po e kërkon dikush me qira. I njëjti iu ka përgjigjur se ecuria e procedurës është se duhet t'i bëhet një kontratë si zakonisht për të gjithë që dëshirojnë të marrin veturë me qira si dhe duhet marrë kopja e letërnjoftimit, e patent shoferit të personit që kërkon veturë dhe duhet bërë pagesa. Në rastin konkret personi i cili kishte shkuar për të marrë veturën me qira në bazë të kamerave të sigurisë rezultoi të jetë këtu L.B.dhe F.M., prindi i të pandehurit E.M.. Më tej dëshmitari shton se të

nesërmen ne mesditë kishin shkuar policia dhe e kishin informuar se me veturën e tij që e kishte dhënë me qira, e cila edhe u identifikua ne bazë të kontratës së dhënë, është bërë një vepër e rëndë penale, vetura i ishte kthyer dhe e njëjta ka qene në rregull. Në fund ka shtuar se është hera e parë që ky person është fjala për të akuzuarin L.B., ka marrë veturë tek ai me qira.

### 3.3. Deklarata e dëshmitarit N.M.

Dëshmitari N.M., gjate marrjes ne pyetje ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se L.B.dhe E.M.i njeh dy javë para se të ndodhë rasti për të cilin është thirrë për të dëshmuar. I njëjti theksoi se ka qene ideja e të gjithëve duke e përfshirë këtu edhe N.Z., që të marrin një veturë me qira ne fshatin Gllamnik, Komuna Podujevë në “R.C. B.”, dhe atë veturë e ka marrë L. dhe me të janë nisur të gjithë për në Prishtinë për t’u shëtitur. Në Prishtinë kanë ardhur kah ora 17-18:00, janë ndalur ne lagjen Dardania, në një kafene ku kanë hyrë brenda dhe kanë pirë nga një kafe, e kjo ka qene rreth orës 20:00 në mbrëmje dhe aty nuk kanë ndenjtur me shume se 30-40 min, kanë biseduar gjatë terë kohës për futboll dhe më pas kanë vazhduar rrugën në këmbë afër 50-100 metra për të marrë veturën. Dhe, gjatë rrugës i kujtohet se e ka parë një grua duke i lëshuar roletat e lokalit – pra duke e mbyllur lokalin, dhe me të marrë veturën kanë vazhduar rrugën për në Fushë Kosovë dhe rrugës janë ndaluar nga policia, ku gjatë kontrollimit të veturës u janë gjetur një pistoletë, një thikë, dorëza, për të cilat gjëra thotë nuk e din se nga u kishin ardhur.

### 3.4. Provat materiale

Nga Lista e armeve te konfiskuara datë 10.03.2017 shihet se një armë e llojit Ekol special 99 me numër serik EU-16070380, 12 fishek lloji i municionit 7.65 sasia 12; Nga Dy vërtetimet mbi marrjen e perkohshme te gjesendeve te dates 10.03.2017 shihet se nga i akuzuari L.B.janë sekuestruar përkohësisht një armë zjarri EU-16070380, 12 fishek – kalibër i vogël S&B 15-7.65 Br, dy maska, tri dorëza, një arme e ftohtë – thikë, një veturë Golf katër, një qelës i veturës dhe një librezë e veturës; Nga vërtetimi tjetër shihet se të akuzuarit E.M.i është sekuestruar përkohësisht nje armë e ftohtë – thikë; Nga kontrata me qira të veturës e dates 09.03.2017 shihet se i akuzuari L.B.e ka mare me qira tipin e veturës WV-Golf 4 ngjyrë metalike me targa të regjistrimit 01-854-JB, pronar “R.a C. te B.” sh.p.k; Nga deftesa mbi kthimin e prones të dates 15.03.2017 shihet se B.H.t, i janë kthyer Vetura Golf 4 me targa 01-854-JB, qelësat e veturës si dhe CRA.nr.0789189; Nga foto dokumentacioni shihen fotot me rastin e kontrollimit të veturës, armë zjarri, fishek, maska të ndryshme, dorëza, arme e ftohtë – thikë, një veturë Golf katër, një qelës i veturës dhe një librezë e veturës. Këto prova materiale as që ishin kontesutese dhe asnjëri nga palët nuk pati asnjë vërejtje, andaj gjykata duke parë saktësinë e të njëjtave ua fali besimin e plotë.

### 3.5. Deklarimi i të akuzuarit L.B.

I akuzuari L.B.gjate dhënies së mbrojtjes së tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se lidhur me kete ceshtje ka dhene nje deklarate prane Prokurorise Themelore ne Prishtine dhe nuk qëndron prane kësaj deklarate, ngase shumë gjëra që nuk janë të vërteta i ka pranuar si të vërteta, vetëm për t’iu shmangur dhunës së ushtruar nga policët. Kurse në mbrojtjen e tij të dhënë në

shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se është e vërtetë se veturën e ka marrë me qira ne Renta Car, dhe për të njëjtën ka paguar çmimin 25 euro dhe, të gjithë së bashku janë nisur për në Prishtinë që të kalojnë kohë. Janë ndalur në lagjen “Dardania”, janë shëtitur pak dhe më pas kanë pirë nga një kafe në një lokal aty afër, pastaj janë nisur që të katërtit për në drejtim të Fushë Kosovës dhe rrugës nga policia janë ndaluar, ku gjatë kontrollimit zyrtarët policor kanë hasur në revolen qe e ka poseduar i akuzuari L.. I njëjti ka shtuar se për këtë armë edhe e ka pranuar fajësinë siç e akuzon prokuroria, ndërsa për sendet tjera të cilat u janë gjetur në veturë ka shtuar se nuk e din se të kujt janë ato.

### 3.6. Deklarimi i të akuzuarit E.M.

I akuzuari E.M.gjate dhënies së mbrojtjes së tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se lidhur me këtë çështje ka dhëne një deklaratë pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe shume gjera i ka pranuar si te verteta, e ne fakt ato nuk ishin reale, por vetem per t'iu shmangur rrahjeve, kercenimeve dhe shantazhave te policise qe ia kishin bërë. Në vazhdim ka deklaruar se nga Podujeva kishin ardhë në Prishtinë me veturë të cilën L. e kishte marrë me qira ne fshatin G.. Me te ardhur ne Prishtine kane shetitur, kane pire kafe ne nje lokal ne lagjen “Dardania”, pastaj perafersisht rreth orës 21:22.00 ka blere edhe nje grisinë-qips ne nje market aty afer kafenesë, pastaj jane shetitur edhe pak dhe jane nisur në drejtim të Fushe Kosoves, rrugës jane ndaluar nga policia, nga shoferi pra nga L. i kane kerkurar dokumentet, e pastaj kane bere kontrollë me ç’rast në xhepin e te akuzuarit E. kane gjetur nje brisk, kurse për sendet tjera si arme, maske dhe doreza nuk ka pasur njohuri se ato gjendeshin ne veture dhe se kujt i perkisnin.

### 4. Elementet e vepres penale

Ne nenin 329 par.3 te KPRK eshte parashikuar forma kualifikuese se “Kryesi i cili vepron si anetar i grupit ose i cili ka me vete arme apo mjete e rrezikshem” dhe, per kete forme te vepres penale eshte parashikuar denimi me gjobe dhe me burgim prej shtate (7) deri ne dymedhete (12) vjet. Sipas kesaj dispozite ligjore, kjo forme e kesaj vepre penale kryhet “Kur kryesi bartë me vete ndonje arme zjarri ose ne rastet kur “ kryersi apo bashkvepruesi me veti barte ndonje arme ose mjete me qellim qe me force apo kanosje ta menjanoje apo nenshtroje rezistencen e personit tjetër”. Ndersa ne paragrafin.1 te nenit te lartcekur eshte parashikuar forma themelore e kesaj vepre penale te cilen e kryen “ Kushdo qe me perdorim te forces apo kanosjes serioze per te sulmuar jeten apo trupin e personit tjetër, e perveteson pasurine e luajtshme te personit te tille me qellim qe t’i sjelle vetes apo personit tjetër dobi pasurore te kunderligjshme, denohet me gjobe dhe me burgim prej tre (3) deri ne dymbedhjet (12) vjet. Kurse, ne nenin 28 te KPRK eshte parashikuar tentativa per te kryer veper penale. Keshtu, ne paragrafin 1 te ketij neni, eshte parashikuar se “Kushdo qe me dashje ndermerr veprime per kryerjen e vepres penale por vepra penale nuk eshte kyer ose elementet e vepres penale nuk jane realizuar, konsiderohet se ka tentuar te kryej veper penale”. Ndersa ne nenin 35 paragrafi 1 te KPRK, eshte parashikuar forma themelore e vepres penale marreveshja per te kryer veper penale, te cilen konsiderohet se e kryen “ Kushdo qe merret vesh me nje apo me shume persona per te kryer veper penale dhe nje apo me shume nga ata perosna

ndermerr cfaredo veprimi te rendesishem per kryerjen e vepres penale denohet me denimin e parapare per ate veper penale”. Kurse ne paragrafin 2 te ketij neni parashikohet se “veprimi i rendesishem drejt kryerjes se vepres penale” nuk duhet te jete veprim penal por duhet te jete hap i rendesishem pergaditor drejt kryerjes se vepres penale te cilen personat jane pajtur qe ta kryejne.

##### 5. Vlerësimi i provave dhe analizimi i provave

Gjykata ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se deklarata e të akuzuarit L.B.nuk ishte kontestuese gjate gjithë mbrojtës se tij vetem sa i perket faktit “se veturën e ka marrë me qira ne “R. C. te B.”, dhe për të njëjtën ka paguar çmimin 25 euro, per faktin se i akuzuari ne tri deklaratat e tij te dhena, si ne polici, prokurori dhe gjykate kishte pohuar faktin e njejte. Kurse pjeset tjera te deklaratave te tij, te dhena ne polici, prokurori dhe ajo ne seancen e shqyrtimit gjyqësor me dëgjimin e tij të drejtëpërdrejtë, gjykata i ka vlerësuar kontradiktore njerën me tjetren, per arsye se **ne polici** kishte potencuar faktin se te gjithë duke i perfshire ketu shoket e tij E.M, N.Z. dhe N.M., kane ardhur ne Prishtine per tu shetitur, që te vizitojne ndonje kafene per te pire dhe pastaj te bejne incizim te nje videoklipi duke gjuajtur me arme si dhe dorezat dhe masken i ka blere ne nje shitore Amerikane “E.”, te cilat i kishin pasë ardhur me poste. Kurse ne deklaraten e tij te dhene **ne prokurori** kishte theksuar se në Prishtine te gjithë kishin ardhur per tu shetitur, por qe nuk kishin pire ndonje kafe ne ndonje kafiteri, dhe me tej kishin vazhduar rrugen per Fushe Kosove me arsye se atje do te pine kafe, ngase ne Prishtine nuk iu eshte dukur interesant diqka, kurse nuk e ka mohuar faktin se E ne nje market gjate shetitjes ne lagjen “Dardania”, e ka blere nje grisinë-qips dhe ne ate market kishte punuar nje femer. Ndersa ne mbrojtjen e tij te dhene ne seancen **e shyrtimit gjyqësor** ka theksuar faktinse janë ndalur në lagjen “Dardania”, janë shëtitur pak dhe më pas kanë pirë nga një kafe në një lokal aty afër pastaj janë nisur që të katërtit për në Fushë Kosovë dhe rrugës janë ndaluar nga policia ku gjatë kontrollimit i është gjetur arma të cilën e ka poseduar, ndërsa sendet tjera të cilat janë gjetur në veturë, sipas tij nuk din se të kujt janë ato. Mirepo pas ballafaqimit me deklaratat e tij te dhena ne polici dhe prokurori, i akuzuari L. ka deklaruar se ne polici eshte dasht te thotë ashtu ngase ka pasur presion, shantazh dhe dhune fizike. Po ashtu ne mbrojtjen e tij, ka theksuar se nuk ka patur per qellim qe keto gjera, si arma, thika, maska dhe dorzat, te cilat i ka poseduar t’i perdore per te tentuar te kryejë vepër penale per te cilen e akuzon prokuroria, e as te kete bere ndonje marrveshje me shoket e tij.

**Po ashtu gjykata e ka vlerësuar** me kujdes edhe deklaraten e të akuzuarit E.M.e cila nuk ishte kontestuese gjate gjithë mbrojtës se tij vetem sa i perket faktit “se veturën e kishte marrë me qira ne “ R. C. te B.”, shoku i tij L.B.. Ndersa pjeset tjera te deklaratave te tij, ishin kontradiktore njera me tjetren, per faktin se **ne polici kishte potencuar** se janë shetitur me veture kah Ulpiana apo te Santea dhe akund nuk janë ndalur, deri te nje parking ku L. veturen e ka ndalur dhe te tre pra L., N.Z. dhe N.M. kane dalur nga vetura, ndersa i akuzuari E. ka qendruar ne veture, dhe pastaj te gjithë jane nisur per ne Fushe Kosove per te ngrënë buke atje. E din qe L. ka pasur nje arme dhe fishek, e po ashtu e din faktin edhe per armen tjetër lodër, ngase e kishte pare ne veture dhe kishte luajtur me te, ndersa gjerat e tjera si maske e doreza nuk ka pas njohuri se gjenden ne veture. Kurse



ne mbrojtjen e tij te dhene ne seancen e **shqyrtimit gjyqesor** i akuzuari E. ka potencuar faktin se me te ardhur ne Prishtine kane shetitur, kane pire kafe ne nje lokal ne lagjen “Dardania”, pastaj perafersisht ka ora 21:22:00, ai kishte blere nje grisinë -qips ne nje market aty afer kafenesë, me pas jane shetitur edhe pak dhe jane nisur rruges per Fushe Kosove, ku edhe janë ndaluar nga policia, nga L. i kane kerkuar dokumentet, e pastaj kane bere kontrollë, ku në xhepin e tij policet kishin gjetur nje brisk te cilin siç thotë rastësisht e ka mbajtur, kurse për sendet tjera si arme, maske dhe doreza nuk ka pasur njohuri se ato gjenden ne veture dhe kujt i perkasin, ndërsa siç thotë nuk kane pasur ndonje marrveshje ne mes vete per te tentuar te kryejnë ndonje veper penale. Mirepo pas ballafaqimit me deklaraten e tij te dhene ne polici, i akuzuari E. ka deklaruar se ne polici eshte dashtë te thotë ashtu ngase ka pasur presion, shantazh dhe dhune fizike. Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes këto pjesë të deklarimeve të të akuzuarve L. e E. dhe ka ardhur ne përfundim se ato nuk jane te besueshme dhe bindëse dhe te njëjtatjane te njëanshme në drejtim të mbrojtjes së tyre, gjykata fillimisht nuk arriti të vërtetojë faktin se të akuzuarit në polici kanë qenë në ndonjë mënyrë të maltretur, sepse në shkresa të lëndës ekziston raporti mjeksor i përpiluar në polici vetëm për të miturin N.M. dhe për të njëjtin nuk është konstatuar asnjë ankesë, andaj deklaratave të tyre në këtë kontest nuk ua fali besimin.

Gjykata poashtu ka vlerësuar dhe analizuar me kujdes edhe deklaraten e te demtuares- deshmitares F.M.,dhe deklaraten e deshmitarit B.H., si dhe te njejtat i ka vlersuar si deklarata bindese, objektive, të sinqerta dhe të arsyeshme, keshtu qe te njejtave ia ka falur besimin e plote. E demtuara F.M., ne deklaraten e saj te dhene ne seancen e shqyrtimi gjyqesor, nuk e ka ndier veten te demtuar nga te akuzuarit, se kinse te njejtit paskan pasur per qellim qe posa te gjejne mundesinë t’a grabisin lokaline ne te cilen ajo punonte dhe, ajo te njejtit me rastin e mbylljes se marketit nuk i ka pare aty afer apo nuk ka vërejtur ndonje gje te dyshimt tek ata se po tentojne te ndermarrin ndonje veprim, e as te njejtit nuk ka mundur t’i identifikojë në gjykatore, ngase me rastin e mbylljes se marketit, personat me kapulaqa ishin 200 m larg lokalit te saj dhe ajo pjesë e lagjes “Dardania” për shkak të kafeneve të shumta është e frekuentuar kryesisht nga të rinjë deri në orët e vona të natës. Ne anen tjeter deklarata e deshmitarit Bekim eshte jokontestuese edhe me deklaratat e te akuzuarve se ditën kritike e kane marrë nje veture me qira nga salloni i tij, kete fakt e kane potencuar edhe te akuzuarit. Mirepo i njejt i nuk ka pasur njohuri se për çfarë arsye e kane marre me qira, derisa veturen ia kane kthyer policet në gjendje të rregullt dhe i kane treguar se me atë veture te tij, të akuzuarit kane tentuar te kryejnë nje veper te rendë penale.

Kurse kur eshte fjala per deshmine e deshmitarit N.M., gjykata te njejten e ka vleresuar si jo bindese, jo te besueshme dhe te njeanshme, per shkak se i njejt i kishte qene me te akuzuarit gjate tere rrjedhes se ngjarjes se nates kritike, se ai ishte i dyshuar poashtu por si i mitur, se i njëjt i në polici kishte pohuar se te gjithë kishin bere plan te vijne ne Prishtine dhe ne ate pjesë te lagjes ne “Dardani”, pasi t’ju vijë mundesia te hyjne ne market dhe të grabisin. Kurse ne deshmine e tij te dhene ne shqyrtimin gjyqesor, i njejt i kishte pohuar krejt ndryshe gjerat, duke theksuar faktin se te gjithë kishin ardhur ne Prishtine vetem per tu shetitur dhe per te pire kafe në ndonje kafiteri dhe gjate tere kohes kishin biseduar per punë futbollit.

Nje gjendje e tille faktike vertetohet edhe nga lista e armeve te konfiskuara datë 10.03.2017 ku shihet se një armë e llojit Ekol special 99 me numër serik EU-16070380, 12 fishek lloji i

municionit 7.65 sasia 12, jane konfiskuar nga zyrtaret policor me rastin e kontrollimit te vetures së të akuzuarve. Po ashtu gjendja faktike vertetohet nga dy vërtetimet mbi marjen e perkohshme te gjesendeve te dates 10.03.2017, ku shihet se nga i akuzuari L.B.janë sekuestruar përkohësisht një armë zjarri EU-16070380, 12 fishek – kalibër i vogël S&B 15-7.65 Br, dy maska, tri dorëza, një arme e ftohtë – thikë, një veturë Golf katër, një qelës i veturës dhe një librezë e veturës. Po ashtu nje gjendje e tille faktike vertetohet se të akuzuarit E.M. i është sekuestruar përkohësisht nje armë e ftohtë – thikë; po ashtu vertetohet se nga kontrata me qira të veturës e dates 09.03.2017 shihet se i i akuzuari L.B.e ka marre me qira veturën e tipit WV-Golf 4, ngjyrë metalike me targa të regjistrimit ..., pronar “R. a C. te B.” sh.p.k; Po ashtu gjendja faktike vertetohet edhe nga deftesa mbi kthimin e pronës të dates 15.03.2017 ku shihet se B.H., i janë kthyer Vetura Golf 4 me targa ..., qelsat e veturës si dhe CRA.nr.0789189; Po ashtu nga foto dokumentacioni shihen sendet me rastin e kontrollimit të veturës, përkatësisht armë zjarri, fishekë, maska të ndryshme, dorëza, thika si dhe vetë vetura Golf 4, një qelës i veturës dhe një librezë e veturës.

#### 6. Konstatimet e gjykatës

Pas mbajtjes se seancave te shqyrtimit gjyqesor dhe administrimit te provave si dhe vleresimit te tyre nje nga nje dhe ne lidhje me provat tjera, konform nenit 361 te KPP, gjykata konstatoi kete gjendje faktike: se nuk eshte vertetuar pertej dyshimit te bazuar mire se te akuzuarit L.B.dhe E.M., qe si anetare te grupit ose te cilet me vete kane armen apo mjetin e rrezikshëm dhe me marrveshje njeri me tjetrin, me dashje, me perdorim te forces apo kanosjes serioze per te sulmuar jeten apo trupin e personit tjetër, të përvetesojnë pasurine e luajtshme te personit te tjetër me qellim qe t’i sjelle vetes apo personit tjetër dobi pasurore te kunderligjshme, te kene tentuar ta kryejne vepren penale Grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK, ne menyren, kohen dhe vendin e pershkruar si ne dispozitivin I te ketij aktgjykimi. Andaj duke pas për bazë parimin **In dubio pro reo**, ku thuhet se: Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarve dhe të drejtave të tyre sipas këtij

Kodi dhe të cilat janë të garantuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me qenë se në rastin konkret nuk ka prova me të cilat do të vërtetohej fajësia e të akuzuarve mbi bazën e të cilave prokuroria e ka mbështetur aktakuzën lidhur me veprimet e të akuzuarve “kushdo qe me perdorim te forces apo kanosjes serioze per te sulmuar jeten apo trupin e personit tjetër, e përveteson pasurine e luajtshme te personit te tille me qellim qe t’i sjelle vetes apo personit tjetër dobi pasurore te kunderligjshme”, e si formë kualifikuese “si anetare te grupit ose te cilet kane me vete armen apo mejtin e rrezikshem dhe marrveshje njeri me tjetrin”, e të cilat janë parapare me nenin 329 par.3 lidhur me nenin 28 dhe lidhur me nenin 35 par.1 dhe 2 të KPRK. Rrjedhimisht gjykata nuk ka vërtetuar se janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale të grabitjes, e që janë përdorimi i forcës apo kanosjes serioze, apo sulmi i jetës apo trupit të personit të tretë, apo përvetësimi i pasurisë së huaj, nga ana tjetër nuk është ndërmarrë asnjë veprim i vetëm nga të

akuzuarit në vendin e ngjarjes në drejtim të kryerjes së veprës penale, pra nuk është shfaqur asnjë lloj rezistence nga pala që prokuroria pretendon se është e dëmtuar, pra, ende pa iu shfaqur të akuzuarve ndonjë pengesë reale e jashtme që do t'i ndalonte apo pengonte ata në moskryerjen e veprës, të njëjtit edhe nëse kanë patur dëshirë të kryejnë vepër penale vullnetarisht kanë hequr dorë nga kryerja e asaj vepre penale ende pa manifetuar ndonjë veprim të dhunshëm, dhe mund të thuhet se dëshira e tyre ka mbetur vetëm dëshirë e perealizuar dhe e pa filluar. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 7. Gjendja faktike e vertetuar

Andaj, duke u bazuar ne keto qe u ceken me larte, gjykata ka vertetuar kete gjendje faktike: - se i akuzuari L.B.; me dashje e ka kryer vepren penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK, ne kohen, vendin dhe menyren e pershkruar si ne piken II te dispozitivit te ketij aktgjykimi.

#### 8. Elementet e vepres penale dhe shpallja fajtor e të akuzuarit L.B.

Ne nenin 374 par.1 te KPRK, eshte parashikuar si forme themelore e vepres penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve, e kryen “kushdo qe mban ne pronesi , kontrollon ose posedon arme me shkelje me ligjin e zbatueshme lidhur me arme te tilla, per te cilen eshte parashikuar denim me gjobe deri ne 7.500€ (shtatemije e peseqind euro) ose me burgim deri ne 5 (pese) vjet”. Ndersa, ne Ligjin per armet, eshte parashikuar se per te mbajtur ne posedim apo pronesi ndonje arme, duhet qe personi te kete leje valide te leshuar nga organi kompetent. Keshtu qe duke u bazuar ne keto dispozita ligjore, gjykata e kashpallur fajtor te akuzuarin L.B., per shkak te vepres penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve, nga neni 374 par.1 te KPRK, ngase veprimet e te njejtit i permbajne te gjitha tiparet e kesaj vepre penale, se është edhe penalisht pergjegjes dhe veprën e kryer e ka pranuar, ndërsa gjykata e ka aprovuar pranim fajsinë nga i akuzuari.

#### 9. Rrethanat qe jane marre per baze me rastin e shqiptimit te denimit

Me rastin e matjes se denimit ndaj te akuzuarit L.B., trupi gjykues i ka marre per baze disa rrethana qe ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, sipas nenit 73 dhe 74 te KPRK. Ne kete aspekt, si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata ka marrë pranimin e fajsisë nga i akuzuari,

pastaj sjellet e mira te të akuzuarit gjate gjithë procesit të gjykimit dhe paraqitjen me kohë në çdo ftesë të gjykatës si dhe faktin se me pare nuk ka qene i dënuar per ndonje veper tjeter penale, ndërsa nuk ka gjetur ndonje rrethane renduese.

#### 10. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallen e përgjegjesisë penale të të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Duke u nisur nga të gjitha të lartëcekurat, gjykata të akuzuarit L.B.i shqiptoi dënimin si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, dhe do të ndikojë ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 11. Vendimi lidhur me paraburgimin

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim në dënimin e shqiptuar, gjykata e mori në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK, dhe atë duke ia llogaritur një ditë paraburgim me një ditë burgim.

#### 12. Denimi plotesues

Perveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62 dhe 69 dhe 374 par.3 të KPRK, ndaj të akuzuarit L.B., shqiptohet edhe denimi plotsues marrja- konfiskimi i armës së zjarrit e llojit “Ekol Special”, me nr.serike SB 15, të kalibrit të vogël 7.65mm.

#### 13. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike.

Gjykata të dëmtuaren F.M. nuk e udhëzoi në kontest të rregullt civilo-juridik, meqë e njëjta shprehimisht u deklarua në shqyrtimin gjyqësor se nuk dëshiron të parashtrojë kërkesë pasurore juridike, sepse fare nuk ndihet e dëmtuar.

#### 14. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 e lidhur me nenin 453 par.1 dhe lidhur me nenin 454, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi për lirimin nga shpenzimet e procedurës penale-paushallit gjyqësor për veprën penale nga pika I e aktakuzës është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPP.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 dhe nenit 365 të KPP u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA PKR.nr.153/2017, datë 23.03.2018**

Zyrtare ligjore  
gjyqtare **Albulena Ademi**

Kryetare e trupit gjyqësor  
**Suzana Çerkini**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë